

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SHPK**

Ky statut dhe akt i themelimit, Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Ligji nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "GG EVENTI & COMUNICAZIONE " SHPK.

KREU I

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfuqësimit, Përgjegjësia e Asamblesë së Përgjithshme

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria mban emrin "GG EVENTI & COMUNICAZIONE " SHPK.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria "GG EVENTI & COMUNICAZIONE " SHPK ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SH.P.K., e ka selinë në Shqipëri, Tiranë, Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pallati 68 - Hyrja 10 - Kati 4 - Banesa 15 1001. Numri i telefonit +39 3774676877 dhe adresa e emailit giovanniconversanosnl@gmail.com:

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

Konsulencë, trajnime për menaxhimin e kompanive, kurse për sigurinë në punë, marketingun dhe prodhimin e produkteve kozmetike, marketingun përmes tregtisë elektronike, organizimin e eventeve dhe panairove, kërkimin shkencor, përzgjedhjen dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, organizimin e shfaqjeve, menaxhimin e mikpritësve (hostes) dhe stjuardëve.

Shitjet online dhe ato offline. Menaxhim e restoranteve, hoteleve, bareve, shërbime catering.

Blerja dhe menaxhimi i të gjitha llojeve të pronave, duke përfshirë shtëpitë e pushimit dhe private.

Blerja dhe menaxhimi i klinikave mjekësore. Shitje dhe marrje me qera makinash.

Shitje-blerje produktesh për estetike, suplemente ushqimore, mjekësi estetike, kirurgji estetike.

Shitje dhe tregtim të produkteve farmaceutike dhe parafarmaceutike.

Blerja dhe menaxhimi i supermarketeve të vogla dhe të mëdha. Operator turistik për vendet evropiane dhe jo-evropiane. Brokerimi i letrave me vlerë dhe i pasurive të paluajtshme.

Aktivitetet e pasurive të paluajtshme dhe të ndërtimit në formën më të gjerë dhe, në veçanti, si shembull: blerja, ndërtimi, prishja, rinovimi, rindërtimi dhe shitja, në grup ose në pjesë, të pronave urbane; blerja dhe shitja e pronave rurale.

Administrimin dhe dhënien me qira të pronave të çdo lloji. Marrja e kontratave dhe nënkontraktimeve nga njerëz ose subjekte, publike dhe private, në aktivitetet e treguara më sipër. Për të arritur objektivat e saj, kompania mund të kryejë kryesisht:

a) çdo transaksion tregtar, industrial, financiar që përfshin pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që gjykohen të nevojshme dhe të dobishme nga organi administrativ, me përjashtim të transaksioneve që mund të rrezikojnë pavarësinë e tij financiare;

b) të marrë direkt ose indirekt interesa ose aksione në shoqëri ose biznese të tjera që kanë një objekt tregtar të ngjashëm ose të njëjtë, por në çdo rast të lidhur.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SH.PK do të jetë për një periudhë të pacaktuar dhe mund të zgjatet.

NENI 6

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

6.1 Shoqëria "GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SHPK mund të hapë degët e saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

6.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. mund të vendosë, transferojë dhe/ose mbyllë, si brenda dhe jashtë shtetit shqiptar, zyra secondare, filiale, seli, agjenci, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

KREU II

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8

Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SHPK. është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

1. **Z. Giovanni Conversano**, atësia Antonio lindur në Campi Salentina (LE) Itali më 07.05.1979 me numër dokumenti CA82625AP, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5.100 (pes mijë e njëqind) lekë e cila përfaqëson 51% të kapitalit të shoqërisë.
2. **Z. Giada Pezzaioli**, atësia Fabio, lindur në Montichiari (BS) në Itali më 02.11.1993 me numër dokumenti AY1110339, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 4.900 (kater mijë e nëntqind) lekë, e cila përfaqëson 49% të kapitalit të shoqërisë.

kapitali i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortakët e shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

NENI 10

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

10.1 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.

10.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

10.3 Kuota mund të pjesëtohet për shkak të kalimit.

10.4 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet e Shoqërisë, vendimmarrese dhe drejtuese

NENI 11

Organi Vendimmarres

11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

11.2 Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

11.4 Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 12

Mbledhja e Asamblesë së Pergjithshme

12.1 Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme (Ortakët e Shoqerisë) do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

12.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë. Vendimet e marra nga Ortakët, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqerisë.

NENI 13

Kuorumi

13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

13.2 Në rastin kur asambleja e pergjithshme duhet të vendosë për cheshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

13.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 14

Marrja e vendimeve

14.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

14.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve.
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

NENI 15

Përfshirja nga e drejta e votës

15.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

15.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 16

Administrimi

16.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

16.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

16.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai/Ajo ka të drejtë të:

- përfaqësojë shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët;
- të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe të depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
 - të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - të përgatisi dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - të krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - të kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
1. **16.4** Administratori i shoqërisë do të jetë Z. **ENDI SINANI**, atesia FERIT, lindur në Tirane Albania më 12.08.1992 me numër dokumenti J20812039E, me një afat 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Specimeni i nënshkrimit të administratorit:

Endi Sinani



NENI 17

Kompetencat e Administratorit

17.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

17.2 Administratorët janë të detyruar të therrasin Asambletë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

17.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 18

Përgjegjësia e Administratorit

18.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

KREU IV

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 19

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

19.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

19.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 20

Shpërndarja e Fitimeve

20.1 Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

20.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

NENI 21

Ekspertët

21.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

NENI 22

Riorganizimi i Shoqërisë

22.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

22.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 23

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

23.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

23.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 24

24.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.


ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"GG EVENTI & COMUNICAZIONE" SHPK

Giovanni Conyersano



Giada Pezzaioli



Tiranë 24.11.2022